



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLICA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 nr. 060/01-4878
Dt: 04.02.2019

NJOFTIM

Komuna e Gjakovës i fton të gjithë qytetarët, personat fizik dhe juridik që ti paraqesin kërkesat e tyre me shkrim, idetë dhe plan projekte me qëllim të marrjes së pronës komunale në shfrytëzim ngase Komuna e Gjakovës është duke u përgatitur që ti zhvilloj të gjitha procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që janë në interes dhe në dobi të qytetarëve.

Kërkesat, idetë dhe plan – projektet e personave fizik dhe juridik për marrjen e pronës komunale në shfrytëzim të jenë të qarta, të jetë e identifikuar prona komunale, të kenë ide zhvillimore dhe qëllimi i shfrytëzimit të ketë dobi për komunitetin.

Komuna e Gjakovës i inkurajon qytetarët që të marrin pjesë në këtë proces në mënyre që të sigurohet se vendimarrja do të jetë në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Të gjitha kërkesat, idetë dhe plan – projektet mund ti dorëzoni çdo dite punë nga data: 04.02.2019 deri me 28.02.2019 prej orës 10:00 deri në ora 15:00, në zyrën e informimit të Komunës së Gjakovës në ndërtesën e ish – Bankosit.